



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1235/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e Iniciativës Qytetare G.I Srpska paraqitur kundër KQZ-së për shkak të publikimit të rezultateve përfundimtare të kandidatëve për asamblenë komunale në Mitrovicën e Veriut për zgjedhjet lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuara ankesa e Iniciativës Qytetare G.I Srpska.

Arsyetim

PZAP-i , më datën 03.12.2013, ka pranuar një ankesë nga G.I Srpska në të cilën theksohet se me vendimin e KQZ-së me të cilin janë publikuar rezultatet përfundimtare për këshilltarët e asamblesë komunale në Mitrovicën e Veriut G.I Srpska është dëmtuar duke fituar më pak këshilltar në raport me numrin e votave të fituara, andaj me këtë rast parashtuesi i ankesës thekson se nuk do ti pranoj rezultatet për asamblenë komunale në Mitrovicën e Veriut nëse nuk rregullohen parregullsitë e bëra nga KQZ-ja.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i nga shkresat e KQZ-së me nr. 2110/A-2013 të datës 06.12.2013 konstatoi se shpërndarja e vendeve nëpër kuvende komunale bëhet në bazë të nenit 8.1 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale me formulën të cilën e zbaton KQZ-ja për shpërndarjen e

votave nëpër asamble, andaj PZAP-i në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur ankesën e lart përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 1235/2013 më datën 06.12.2013.



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.